

Prof. Dr. Maksim HAXHIA
Rr. "Blv. Dëshmorët e kombit", Nd.6, H.11, ap.21,
Njësia administrative nr.5, Kodi Postar nr. 1019,
Tiranë-Shqipëri.

Tiranë më 19.04.2021

Me postë: Avokatit të Popullit,
Rr. "Vllazën Huta", Tiranë, Shqipëri.

Drejtuar: Avokates së Popullit.
Znj. Erinda BALLANCA.

E Nderuar Znj. Avokate,

1. Arsyeja që po Ju drejtohem nëpërmjet kësaj letre qëndron mbi faktin që Ju si institucion, keni treguar një interes dhe qëndrim korrekt ndaj çështjeve për shkelje të së drejtave të njeriut.
2. Profesor Selim ÇEKAJ, është diplomuar në Universitetin e Tiranës më datën 14.05.1974 me titullin "Mësues i gjuhës dhe letërsisë Shqipe për shkollat e mesme", Fakulteti Histori-Filologjisë. Ai ka punuar për më shumë se 35 vjet në profilin e mësuesit të gjuhës dhe letërsisë Shqipe dhe drejtorit të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare.
3. Profesor Selim ÇEKAJ është administrator i Shoqërisë "Ecoalmax" e regjistruar pranë QKB-së, në datën 21.03.2018. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është: "kryerja e cdo aktiviteti tregtarë të lejuar nga ligji dhe /ose pjesëmarrja në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryej një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar. Investimet në fushën e medias, informacionit, reklamës dhe marketingut, import, eksport, prodhim, tregtimi i artikujve të ndryshëm të gjithave llojeve me shumicë dhe pakicë."
4. Shoqëria "Ecoalmax", është krijuar me qëllimin e vazhimit të aktivitetit tregtar të nisur nga Shoqëria "Arbri Garden" dhe administratori i saj Arbër ÇEKAJ (i biri), të cilët kanë marrë kredi pranë bankës "Procredit" Bank sh.a dhe më konkretisht;
 - Në datë 24.09.2014 midis "Procredit" Bank sh.a në cilësinë e "Kredi-dhënësit" dhe palëve të tjera si Shoqëria "Arbri Garden" sh.p.k në cilësinë e "Kredi-marrësit" dhe Arbër Çekaj dhe Eridona Çekaj në cilësinë e "Debitori Solidar" është lidhur Kontrata e Kredisë me nr. 05000238. Sipas Aneksi 2, bashkëlidhur kësaj kontrate, Shoqëria "Arbri Garden" ka marrë kredi në vlerën 300,000 (treqind mijë) Euro.

- Në datë 13.03.2017 midis “Procredit” Bank sh.a në cilësinë e “Kredi-dhënësit” dhe palëve të tjera si Shoqëria “Arbri Garden” sh.p.k me cilësinë e “Kredi-marrësit” dhe Arbër Çekaj dhe Eridona Çekaj në cilësinë e “Debitori Solidar”, është lidhur Kontrata e Kredisë me nr. 91000086. Sipas Aneksi 2, bashkëlidhur kësaj kontrate, Shoqëria “Arbri Garden” ka marrë kredi në vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Euro.
 - Në datë 30.04.2017 midis “Procredit” Bank sha.a me cilësinë e “Kredi-dhënësit” dhe palëve të tjera si Shoqëria “Arbri Garden” sh.p.k në cilësinë e “Kredi-marrësit” dhe Arbër Çekaj dhe Eridona Çekaj në cilësinë e “Debitori Solidar” është lidhur Kontrata e Kredisë me nr. 05001392. Sipas Aneksi 2, bashkëlidhur kësaj kontrate, Shoqëria “Arbri Garden” ka marrë kredi në vlerën 25,000,000 (njëzet e pesë milion).
5. Profesor Selim ÇEKAJ, pavarësisht se në moshën 72 vjeçare, ka qenë personi i vetëm nga familja ÇEKAJ, i cili duhej të punonte për të mbajtur familjen dhe të paguante këstin mujor për kreditë e marrë pranë “Procredit” Bank.
 6. Shoqëria “Ekoalmax” nga momenti i regjistrimit dhe deri në momentin e ndodhjes së faktit të paligjshëm, (një fakt i pavarur nga vullneti i tij), ka qenë një shoqëri tatim pagues e rregullt pranë organeve të posaçme në Republikën e Shqipërisë.
 7. Shoqëria “Ekoalmax” ka bashkëpunuar për blerjen e frutave banane me Shoqërinë “Ecuadres S.A” në Ekuador, në zbatim të kontratës CIF. Sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratën CIF, përcaktohet se përgjegjësinë për frutat që nga nisja e deri në momentin e magazinimit pranë Shoqërisë “Ekoalmax”, e ka Shoqëria “Ecuadres”. Pra përgjegjësinë për frutat e ka Shoqëria “Ecuadres” dhe përgjegjësinë për kontenierin e ka Shoqëria përkatëse “Maersk”.
 8. Në datën 1 Prill 2021, në portin e Durrësit është nxjerr me risk nga skaneri kontenieri i Shoqërisë “Maersk”, e cila kishte ngarkuar bananet e Shoqërisë “Ecuadres”, në Ekuador të porositura sipas Kontratës një vjeçare që kishin lidhur shoqëritë . Ky është dhe momenti i fillimit të veprimeve të paligjshme të kryera në dëm të Profesor Selim ÇEKAJ, nga ana e organeve të Policisë Durrës, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Prokurorisë së Posaçme dhe vetë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
 9. Përpara se të analizojmë në mënyrë shumë të thjeshtë dy veprimet e kryera nga Profesor Selim ÇEKAJ, na lejoni të paraqesim dhe një përshkrim të detyrave kryesore që ka Policia e Shtetit dhe Prokuroria në Republikën e Shqipërisë.
 - Policia e Shtetit ka si mision garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.
 - Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik

- *Prokurorët sigurojnë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, pronës, arsimimit, lindjes, aftësisë së kufizuar, origjinës shoqërore, përkatësisë prindërore ose për arsye të tjera.*
10. Në rastin konkret, Policia e Shtetit dhe Prokuroria kanë paragjykuar duke e arrestuar profesor Selim ÇEKAJ me dyshimin e trafikimit të lëndëve narkotike, pasi rezulton se ai nuk ka dalë njëherë nga Republika e Shqipërisë, nuk njih gjuhët e huaja Anglisht apo Spanjisht, gjuhë të nevojshme për të komunikuar me trafikantët në Ekuador. Pra, ky person sipas paragjyqimit të policisë dhe prokurorisë ka kryer trafikimin e lëndës narkotike e cila u gjend në kontenierin në pronësi të Shoqërisë “Maersk”.
 11. Pyetja që ne shtrojmë me shumë shqetësim të madh është fakti se përse policia dhe prokuroria në asnjë rast të vetëm të kapjes së lëndëve narkotike në portin e Durrësit nuk arreston administratorin e shoqërive që kanë në pronësi kontenierët apo personat përgjegjës të lidhur me kontenierët ??? Përse policia dhe prokuroria në rastet kur evidenton dhe dyshon se kontenierët kanë lëndë narkotike të fshehur, nuk heton me metoda të specializuara për zbuluar se kush janë njerëzit e interesuar për lëndën narkotike dhe ku do të hapen këta kontenierë ???
 12. Pra, në asnjë rast, organet e policisë dhe prokurorisë nuk ushtrojnë detyrat në funksion dhe në zbatim të ligjit, të realizojnë një hetim objektiv dhe të pa-paragjykuar.
 13. Në rastin konkret, prokuroria dhe policia e shtetit e thërrasin profesor Selim ÇEKAJ pranë portit të Durrësit dhe e arrestojnë në flagrancë, duke bërë bujë mediatike dhe në kundërshtim me nenin 252 të Kodit Procedurës Penale i cili përcakton se *“Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerjen e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia ose ai që është kapur me sende dhe prova materiale nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.”*
 14. Pra, në analizë të nenit 252 i Kodit Procedurës Penale, del qartësisht e vërtetueshme bazuar nga dinamika e zhvillimit të ngjarjes por edhe në raport me provat e administruara nga organi i prokurorisë se arrestimi në flagrancë është i pambështetur në ligj dhe në prova.
 - Së pari**, rezulton se profesori Selim ÇEKAJ nuk është kapur në kryerjen e sipër të veprës penale pasi nuk ka rezultuar asnjë provë apo indicie sado e vogël që të lidh dyshimin e organit të prokurorisë me dijeninë e tij për ngarkesën e lëndës narkotike në kontenierin që transportonte bananet që ishin porositur nga Shoqëria “Ecoalmax”.
 - Së dyti**, nuk ka rezultuar që ai të jetë kapur me sende dhe prova materiale nga të cilat duket se ka kryer veprën penale, pasi veprimi i vetëm që ka kryer profesor Selim ÇEKAJ ka qenë porositja e bananeve, veprim i cili është realizuar në zbatim të kontratës një vjeçare që ai ka me Shoqërinë “Ecuadres” në Ekuador. Ai nuk ka marrë pjesë as në ngarkimin e bananeve por as në përzgjedhjen e kontenierit.
 15. Duhet të theksojmë se sipas marrëveshjes CIF që ka Shoqëria “Ecoalmax” me Shoqërinë “Ecuadres” S.A, bananet e porositura nuk janë pronësi e Shoqërisë “Ecoalmax” deri në

momentin që ato nuk shkarkohen në magazinat e shoqërisë. Ky element kontraktual na tregon faktin ligjor që nëse Shoqëria “*Ecuadres*” do të ketë probleme gjatë transportimit të tyre për çdo arsye, Shoqëria “*Ecoalmax*” nuk mban përgjegjësi për bananet apo sendet e paligjshme që mund të gjenden në këto banane. Pra, edhe sikur të supozojmë që lënda narkotike do të ishte konstatuar e fshehur në bananet e porositura nga Shoqëria “*Ecoalmax*”, organi i policisë dhe prokuroria duhej të kishin pritur momentin që ato të shkarkoheshin pranë magazinave të shoqërisë dhe në momentin që ato do të magazinoheshin dhe do të konstatohej ky fakt nga ana e administratorit të shoqërisë dhe ai nuk do të kallëzonte pranë organit të policisë, atëherë do të ishin përpara konsumimit të elementëve të veprës penale të trafikimit.

16. Shoqëria dhe administratori i saj nuk mund të mbajnë përgjegjësi ligjore për një mall që nuk është në pronësinë e tyre, që administratori i shoqërisë nuk merret me ngarkimin e mallit në vendin nisjes, por edhe faktin e pamundësisë për të përzgjedhur kontenierin me të cilin do të ngarkohen bananet e porositura. Në rastin konkret, lënda narkotike është gjendur e fshehur në kontenier, send ky që nuk është në pronësi të Shoqërisë “*Ecoalmax*” dhe nuk mund të konceptohet që sendi i paligjshëm i gjendur dhe i fshehur brenda kontenierit, pronësi të një subjekti që nuk ka lidhje Shoqërinë “*Ecoalmax*”, të aludohet dhe paragjykohet administratori i shoqërisë që ka porositur banane ndërsa administratori i shoqërisë që ka në pronësi kontenierët apo persona të tjerë të lidhur me kontenierët, nuk aludohet apo paragjykohet që mund të jenë në dijeni apo të kenë një rol të posaçëm në fshehjen e lëndës narkotike.
17. Nga ana e gjykatës dhe prokurorisë, nuk janë respektuar garancitë specifike të parashikuara nga ligji procedural por edhe KEDNJ-ja. Neni 6 § 1 e detyron çdo gjykatë që i përket fushës së tij të zbatimit që të jetë “e paanshme”. **Neni 6 § 2 i Konventës** “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.”
18. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që, teksa përmbushin detyrat e tyre, anëtarët e gjykatës nuk nisen nga paramendimi se i pandehuri e ka kryer aktin që i vihet në ngarkim; barra e provës rëndon mbi akuzën dhe dyshimi është në favor të të akuzuarit. Për më tepër, i takon kësaj të fundit që t’i tregojë të interesuarit se çfarë do t’i vihet në ngarkim – në mënyrë që t’i japë atij rastin për ta përgatitur e parashtruar si duhet mbrojtjen e vet – dhe që të paraqesë prova të mjaftueshme për të mbështetur një deklarament fajësie. Këto parime janë shkëlur nga organi i akuzës dhe gjykata duke mos paraqitur asnjë provë konkrete në seancën gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal duke paragjykuar kryerjen e veprës penale nga shtetasi Selim ÇEKAJ.
19. Gjithashtu, pohimet e autoriteteve publike e kanë cënuar parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi e kanë cilësuar si trafikant, pronarin e lëndës narkotike të sekuestruar në një kohë që shtetasi Selim ÇEKAJ është vetëm pronar i bananeve (në momentin që vijnë në magazinën e shoqërisë), të eksportuara nga Ekuadori, ndërsa lënda narkotike e llojit kokainë është gjendur në kontejnerët të cilët janë pronësi e Shoqërisë “*Maersk*”.

20. Gjykata ngul këmbë te rëndësia e zgjedhjes së fjalëve të përdorura nga nëpunësit publikë në deklaratat e tyre lidhur me një person që ende nuk është gjykuar e njohur fajtor për një vepër penale të caktuar. (*Arrigo e Vella k. Maltës*)
21. Gjithashtu, çështja është zhvilluar nën klimën e një fushate shtypi plot vrer dhe informacione të pavërteta, të cilat e kanë dëmtuar sidoqoftë rregullsinë e një procesi duke ndikuar mbi opinionin publik, e për rrjedhojë, te gjyqtarët dhe prokurorët të cilëve u kërkohet të shprehen rreth fajësisë së të akuzuarit (*Kuzmin k. Rusisë, § 62*).

E Nderuar Znj. Avokate,

1. Fakti që po ju drejtohem ju e nderuar, qëndron në problemin se ndaj shtetasit Selim ÇEKAJ po zhvillohet një proces jo i rregullt ligjor, një proces i cili nuk është i bazuar në ato garanci që parashikon KEDNJ-ja, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi i Procedurës Penale.
2. Përfundimisht, kërkojmë nga ju e nderuar, të dërgoni një përfaqësues të Avokatit të Popullit për të ndjekur dhe monitoruar hetimin.

Me konsideratë,

Prof. Dr. Maksim R. Haxhia

